

Raporti Narrativ Vjetor 2018**1. Informacion i përgjithshëm**

Periudha:	Janar 2018 – Dhjetor 2018
Emri i organizatës:	Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”
Adresa zyrtare:	L. 3 Rr. Egnatia Nr 109, Durrës
Kodi postar:	2001
E- maili:	info@udhetimiilire.org
Faqe web:	www.udhetimiilire.org
Personi i kontaktit:	Miranda Mansaku
E-mail:	mirandamansaku@udhetimiilire.org
Phone number:	++355695720494

1. Përmbledhje e aktivitete të realizuara

1.1 Projekte të implementuara dhe në proces

➤ Në muajin Tetor 2017, shoqata ka filluar implementimin e projektit “Youth Eco Act” i cili përfundoi më 30.09.2018. Ky projekt është i mbështetur nga Grantet Operacionale të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENiOR-II) që zbatohet nga REC - Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri, mbështetur dhe financuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar:

- Vendosija e koshave të diferencuar në sitet arkeologjike të qytetit dhe në disa shkolla target të projektit ;
- Trajnime me grupin e vullnetarëve mbi rëndësinë e edukimit mjedisor dhe riciklimit ;
- Takime ndërgjegjëse me nxënës të shkollave të mesme, target të projektit ;
- Hartimi dhe publikimi i planit strategjik të shoqatës;
- Ekspozita “Turizmi & Riciklimi” u zhvillua nga data 18.04.2018 – 22.04.2018 e cila përkon me ditën e Monumenteve kulturore dhe ditës së Tokës. Në të cilën morën pjesë nxënës nga pesë shkolla të mesme të qytetit të Durrësit. Secila nga shkollat dhe secili nga nxënësit morën certifikatë pjesëmarrje. Tre nxënësit me punimet më të mira morën certifikatë vlerësuese.
- “Dita pa qese plastike” në të cilën vullnetarët e shoqatës shpërndan çanta për të ndërgjegjsuar blerësit për mospërdorimin e qeseve plastike.

➤ Që nga muaji Shkurt deri në muajin Qershor 2018 Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” implementoi projektin "Clean today -Healthy Tomorrow" me mbështetjen e Raiffeisen Invest dhe në bashkëpunim me pesë shkollat e mesme të qytetit të Durrësit si: Benardina Qerraxhi, Olsi Lasko, Beqir Çela dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar:

- Vendosija e koshave të diferencuar në shkolla e targetuara për këtë projekt;
- Trajnime me grupin e vullnetarëve mbi rëndësinë e edukimit mjedisor dhe riciklimit;
- Takime ndërgjegjëse me nxënës të shkollave të mesme, target të projektit;
- Ekspozita përmbyllëse në datë 05.06.2018 në kuadër të ditës së Mjedisit, me tematikë “Monumente arkeologjike me materiale të ricikl-ueshme”. Të gjithë nxënësit që morën pjesë me punime u paisën me certifikatë pjesëmarrje ndërsa nxënësit Ervis Dautaj, Belkiza Gjipali dhe Afrim Lleshi morën përkatësisht vendin e parë, të dytë dhe të tretë. Shkolla “Beqir Çela” fitoi edhe pemën e ullirit për shkak të numrit të lartë të punimeve që paraqit në ekspozitë. Përmes krijimeve të nxënësve u përcoll edhe njëherë mesazhi se sa të rëndësishëm janë mjedisi dhe monumentet kulturore në qytetin e Durrësit. Ekspozita u publikua në rrjetet sociale dhe median lokale duke e rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin e publikut.

➤ Nga 01.04.2018 – 31.03.2019, shoqata në bashkëpunim me Fondacionin “Së Bashku” ka zhvilluar një cikël trajnimesh në kuadër të projektit “*Forcimi i kapaciteteve të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës dhe ngritja e çështjes së aksesueshmërisë me të gjithë aktorët lokalë*”. Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Trajnimet kishin temat si më poshtë:

- “Lidershipi dhe Advokacia” në të cilin morën pjesë aktivist dhe përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës si dhe vullnetar të shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”.

- “Modelet e aftësisë së kufizuar dhe statistikë, Konventa e OKB-së dhe legjislacioni shqiptar” dhe këtu pjesëmarrja ishte e lartë si nga ana e përfaqësuesve të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës dhe nga vullnetarët tanë.

- “Menaxhimi i organizatave dhe çështjet financiare”, në këtë trajnim morën pjesë individë nga organizatat e aftësisë së kufizuar në Durrës të cilët dëshironin të zgjeronin njohuritë e tyre për çështjet financiare.

- Një sesion i veçantë dedikuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për eliminimin e barrierave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuar”.

- “Soft skills”

➤ Nga 5 shtatori 2018 deri në 30 nëntor 2019 shoqata ofron: Mbështetje teknike për “Analizë lokale kontekstuale për sistemin e portit të Durrësit” për projektin Transport i Integruar dhe i Qëndrueshëm në Rrjetin Efikas - ISTEN, në kuadër të Programit INTERREG Adriatik-Jon. Projekti po implementohet nga Qarku i Durrësit si partner në këtë projekt.

➤ Nga muaji Gusht 2018 deri në 31 dhjetor 2019 shoqata është Eksperti i jashtëm për përkrahjen e Këshillit të Qarkut të Durrësit në krijimin e hartës së rrezikut të bregdetit EUSAIR, duke ndihmuar në ngritjen e rrjetit I-Storm, për projektin “*Integrated Sea sTORM Management Strategies*” I-STORM, në kuadër të programit INTERREG VB Adriatiko-Jonian. Projekti po implementohet nga Qarku i Durrësit si partner në këtë projekt.

➤ Nga Qershori i 2018 deri në Qershorin e 2019 shoqata është partnere në projektin Erasmus “Të rinjtë dorë për dorë për të pastruar detet” së bashku me Drejtorinë e Rinisë dhe Sporteve në Bashkinë e Stambollit.

1.2 Aktivitete të tjera të realizuara në kuadër të nismave të ndryshme

Janar 2018

- Ekspozita “Gavril Priftuli” u zhvillua në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe shkollën e mesme “Jan Kukuzeli”. Nxënësit morën pjesë me pikturat e tyre të cilat u ekspozuan në galerinë “Nikolet Vasia”. Përmes kësaj ekspozite shoqata ndihmoi në gjallërimin e jetës kulturore në qytetin e Durrësit dhe paisjen me certifikatë pjesëmarrje të të gjithë të rinjve që sollën punime. Tre vendet e para morën certifikata si fitues.

Mars 2018

- Në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit u zhvillua prezantimi i librit "Nazario Sauro - Historia e nje marinari" në sallë e Këshillit Bashkiak Durrës. Libri u prezantua nga Admirali Romano Sauro, nipi i Heroit Nazario Sauro, figurë e rëndësishme që ndikoi në kryengritjen e shqipëtarëve gjatë viteve 1911-1912.

Prill 2018

- Sftafi i shoqatës zhvilloi një ekskursion një ditor në Lagunën e Karavastasë për të njohur nga afër vlerat që kjo zonë e mbrojtur ka.
- Në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar shoqata zhvilloi në sallën e Këshillit Bashkiak workshopin me temë “Të veprojmë së bashku në formimin e politikave rinore në nivel lokal dhe qendror, përmes dialogut të strukturuar” në të cilin morën pjesë z. Florian Tahiri Nënkyetar i Bashkisë Durrës, z. Lavdosh Beqiraj Drejtor i Kabinetit, z. Adrian Gurra Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-Kulturës-Sportit-Rinisë-Komuniteteve Fetare, anëtar të qeverive të nxënësve, etj.

Maj 2018

- Një pjesë e vullnetarëve të shoqatës iu bashkuan festës në Parkun Shebenik – Jabllanicë në vijim të aktiviteteve për njohjen e zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Qershor 2018

- U zhvillua trajnimi me temë “Monitorimi i të Dhënave Mjedisore dhe Menaxhimi i Informacionit në nivel vendor”, në qytetin e Durrësit në kuadër të programit të REC "Krijimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Informacionit Mjedisor në Shqipëri në përputhje me raportimin mjedisor global".

- Në bashkëpunim me KRK në kuadër të projektit “Manual për Qytetarinë Aktive - Udhëzues për angazhimin e të rinjve” u zhvillua trajnimi për lobim, advokaci, komunikim dhe imazh i cili i paraprin përgatitjeve për fushatën e Aktivizmit Rinor. Të gjithë të rinjtë e trajnuar morën certifikatë pjesëmarrje.

Korrik 2018

- Shoqata zhvilloi Kampin Veror me të rinj përfaqësues të komuniteteve fetare Katolike, Myslimane dhe Ortodokse të qytetit të Durrësit. Në të morën pjesë Adrian Gurra Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-Kulturës-Sportit-Rinisë-Komuniteteve Fetare dhe Drejtoresha Ekzekutive e Kongresit Rinor Kombëtar. Ky kamp zgjati dy ditë dhe të rinjtë morën certifikatë pjesëmarrje.

Shtator 2018

- Shoqata zhvilloi Javën Europiane të Lëvizshmërisë në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, Drejtorinë e Rinisë, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare në Bashkinë Durrës, Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës, Policinë e Shtetit dhe shkollat e mesme dhe nëntë vjeçare të qytetit. E reja kësaj here ishte koncepti i multimodalitetit i cili është tejet i rëndësishëm në kushtet që është organizimi i lëvizjeve në qytetin e Durrësit.

Tetor 2018

- Oragnizimi i koncertit recital të korit italian "La Gerla" në bashkëpunim me Bashkinë Durrës. Ky kor ka performuar edhe në shtete të tjera si Japoni, Belgjikë, Francë, Rusi, etj.
- “Youth 4 solution”, prezantuar nga vullnetarët e shoqatës " Udhëtimi Lirë – Liberi di Viaggiare" rezultoi një nga 3 fituesit e projektit "Youth for community, a new momentum for civic activism". Implemementuar nga Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Hans Seidel Stiftung.

Dhjetor 2018

- Në kuadër të projektit “Të rinjtë dorë përdore për të pastruar detet” një grup vullnetarësh morën pjesë në Samitin e Parë Ndërkombëtar të Mjedisit të zhvilluar nga Drejtoria e Rinisë dhe Sporteve në Bashkinë e Stambollit.
- Në kuadër të projektit “Largimi, mbërritja, kthimi: dje, sot, nesër” që po zhvillohet nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në partneritet me Unisco, Shkolla Leonik Tomeo Durrës dhe Gjumnazhin ISS Pietro Sette (Bari), u zhvillua një ekspozitë me nxënësit e gjumnazhit Leonik Tomeo synonte ndërgjegjësimin e të rinjve mbi karakteristikat e fenomenit të emigrimit shqipëtar. Në kuadër të këtij projekti do të zhvillohen edhe aktivitete të mëtejshme.

2. Pjesëmarrje në aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimeve me struktura dhe donatorë të ndryshëm

Trajnim 12 Janar – 13 Janar ReLoAd

Përfaqes nga shoqata së bashku me Drejtoreshën Ekzekutive Miranda Mansaku morën pjesë në trajnimin e zhvilluar nga Bashkia e Durrësit dhe UNDP për shkrimin e projekteve ReLoAd.

Trajnim 6 Shkurt – 7 Shkurt “Rritja e kapaciteteve të organizatave mjedisore”

Një pjesë e stafit të shoqatës morën pjesë në një trajnim dy ditor të zhvilluar nga REC për rritjen e kapaciteteve të organizatave të reja të sorganizatave mjedisore.

Asambleja e VI e Kongresit Rinor Kombëtar 13-14-15 Qershor

Përfaqësues të shoqatës së bashku me Drejtoreshën Ekzekutive Miranda Mansaku dhe përfaqësues të grupeve informale të shoqërisë civile në Durrës morën pjesë në Asamblenë e VI të Kongresit Rinor Kombëtar. Aktivitet zgjati tre ditë dhe në fokusin e tij kishte kontributin që organizatat kishin dhënë për fuqizimin e të rinjve. Në përfundim të aktivitetit u zgjodhën edhe tre anëtarët e rinj të Bordit Drejtues të KRK, një prej tyre ishte edhe përfaqësuesja e Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” Mirjona Hoxhallari.

Konferenca e Lancimit të Ligjit të Rinisë 18 Korrik

Si anëtarë të Kongresit Rinor Kombëtar të përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive e shoqatës morën pjesë në Konferencën e lancimit të Ligjit të Rinisë dhe u njohën me draftin e hartuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Pjesëmarrës të tjerë ishin përfaqësues nga shoqëria civile, të rinj, etj.

Konferencë me temë “Roli i rinisë në ndërtimin e paqes dhe sigurisë” 12 Gusht

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë si anëtarë të Kongresit Rinor Kombëtar morën pjesë në tre ditë aktivitete së bashku me të rinjtë e Kosovës.

Trajnimi Junior fellowship 10-15 Shtator

Një nga vullnetarët e shoqatës mori pjesë në trajnimin “Junior fellowship” si pjesë e programit (SENiOR-II), që zbatohet nga REC dhe financohet nga Ambasada Suedeze në Tiranë. Trajnimi kishte si synim rritjen e kapacitetit të të rinjve për shkrimin e projekteve.

Takim në kuadër të nismës “Drejt një dialogu më efektiv” 29 Shtator

Përfaqësues të shoqatës morën pjesë në takimin e zhvilluar në kuadër të nismës “Drejt një dialogu më efektiv” të Kongresit Rinor Kombëtar. Gjatë takimit u prezantuan gjetjet e Monitorimit për vitin vitin 2017-2018.

Youth exchange “Europeanët bëhen bashkë” 14-19 Tetor

Drejtoresha Ekzekutive e shoqatës si pjesë e Kongresit Rinor Kombëtar mori pjesë në një youth exchange në Francë nën moton “Europeanët bëhen bashkë” e cila lidhet me aspektin social, kulturor dhe politik për të ardhmen e përbashkët në Bashkimin Europian.

International Network Meeting 19-21 Tetor

Përfaqësues të shoqatës morën pjesë në një youth exchange në Berlin të organizuar nga Organizata “Deutsche Schreberjugend”. Fokusi ishte tek mjedisi dhe tek fryma mjedisore që duhet përcjellë tek brezat e rinj që në arsimin parashkollor.

Konsultimi mbi Ligjin e Rinisë 10 Nëntor

Një grup të rinjsh së bashku me Drejtoreshën Ekzekutive të shoqatës morën pjesë në konsultimet e bëra me publikun për Ligjin e Rinisë dhe dhanë sugjerimet e mendimet e tyre lidhur me ndryshimet që duhen bërë

Trajnim “Politikbërje me Pjesmarrje” 20-21 Nëntor

U zhvillua një trajnim dy ditor nga Partnerët Shqipëri ku morën pjesë disa vullnetarë të shoqatës. Fokusi i trajnimit ishte shpërndarja e shembujve të mirë të përfshirjes së komunitetit në politikbërje. Në fund të rinjtë e trajnuar morën certifikatë. Gjatë takimit u krijuan kontakte për shkëmbimin e eksperiencave me shoqata sllovaqe.

Konferenca Interreg MED 15-16 Nëntor

Konferenca e tretë transnacionale e Interreg MED Green Growth Community u zhvillua për herë të parë në Ballkan dhe pikërisht në qytetin e Durrësit. Shoqata si anëtare e rrjetit të Green Growth Community mori pjesë në konferencën dy ditore.

Konferenca e “Ndërtimit të Planeve Lokale për Rininë” 23 Nëntor

Në kuadër të Konferencës mbi “Ndërtimin e Planeve Lokale për Rininë” nga seritë e “Një dialogu më Efektiv” të ndërmarra nga Kongresi Rinor Kombëtar shoqata mori pjesë duke

paraqitur Planin Lokal të Veprimit për Bashkinë Durrës. Në këtë takim së bashku me përfaqësuesit e shoqatës mori pjesë dhe znj. Nikoleta Petro si përfaqësuese e pushtetit vendor, Bashkisë Durrës si mbështetës të këtij aktiviteti.

Aktivitet në kuadër të programit “Best of Best” 1 Dhjetor

Si përfaqësuese e shoqatës në Bordin Drejtues të KRK Mirjona Hoxhallari mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të programit “Best of Best” duke dhënë shembullin se si organizatat lokale mund të bëhen pjesë e KRK dhe benefitet e këtij anëtarësimi.

Takim i Kongresit Rinor Kombëtar 7 Dhjetor

U përfaqësua në takimin e organizuar nga Kongresi Rinor Kombëtar për publikimin zyrtar të rezultateve të raportit të monitorimit mbi performancën e ministrive të linjës dhe kryesisht të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë lidhur me zbatueshmërinë e Planit Kombëtar të Veprimit dhe dorëzimi zyrtar i dokumentit kundrejt Zv. Ministrit të Arsimit që përmban pikëprerjet e të githa komenteve dhe rekomandimeve të ardhura nga e gjithë Asambleja e Kongresit për gjatë gjithë procesit të ndërtimit të Draft Projektligjit të Rinisë.

3. Anetaresime në rrjete

Shoqata “Udhëtimi i lirë” është pjesë e disa rrjeteve si më poshtë:

- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Anna Lindh Foundation.
- ✓ Anëtare e Kongresit Rinor Kombëtar.
- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Earth Day Network.
- ✓ Anëtare e GKP (Grupit Kombëtar të Punës) për RAP (Reformën në Administratën Publike).
- ✓ Anëtare e Platformës së Bashkëpunimit Rinor të Ballkanit Perëndimor.
- ✓ Anëtare e rrjetit Skillman
- ✓ Anëtare e rrjetit Green Growth Community

4. Partnerë të organizatës

Shoqata “Udhëtimi i lirë” ka ndërtuar një bashkëpunim dhe mbështetje nga struktura të ndryshme, të cilat janë pjesë e nismave dhe projekteve që janë implementuar dhe po implementohen kjo e fundit:

- ✓ Bashkia Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 27.04.2017 Nr. 9591 Prot)
- ✓ Këshilli i Qarkut Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 22.08.2017 Nr. 975 Prot)
- ✓ Bashkia Shijak (Marrëveshje bashkëpunimi datë 21.08.2017 Nr. 2992 Prot)

- ✓ Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës
- ✓ Kongresi Rinor Kombëtar
- ✓ Shkollat e mesme të përgjithshme “Naim Frashëri”, “Gjergj Kastioti”, “Leonik Tomeo”, “Olsi Lasko”, “Dom Nikoll Kaçorri” Durrës.
- ✓ Shkolla e mesme sportive “Benardina Qerraxhi”
- ✓ Shkolla e mesme e profesionale “Beqir Çela”, “Hysen Çela”.
- ✓ Shkolla e mesme artistike “Jan Kukuzeli”

5. Donatorë

Shoqata “Udhëtimi i lirë” është mbështetur financiarisht në iniciativat e saj, nga:

- ✓ IDM (Institute for Democracy and Mediation) përmes fondeve EU,
- ✓ REC përmes programit Senior,
- ✓ Bashkia Durrës
- ✓ Raiffeisen INVEST
- ✓ CDI
- ✓ Këshilli i Qarkut Durrës

6. Projekte të përfunduara

➤ Projekti “*Qytetarë aktiv në monitorimin dhe përmirësimin e qeverisjes vendore në Bashkinë e Shijakut*”, i cili u zbatua gjatë harkut kohor 01.05.2017 – 31.10.2017 dhe mbështetur nga fondi i nëngrantimit "Lot 1- Anti-korrupsioni dhe zhvillimi i kapaciteteve" në kuadër të projektit CIVILISC, zbatuar nga IDM, financuar nga BE.

Në kuadër të këtij projekti u ndërmorën këto aktivitete:

1. *takime me bazë komunitare me target grupe të ndryshëm të zonës së Shijakut*
2. *fokus grupe dhe intervista me antarë të ndryshëm të komunitetit (biznese, ndërlihdësa komunitarë, ëprfaqësues të strukturave shtetërore lokale etj) me qëllim evidentimin e nivelit të kënaqësisë së shërbimeve të ofruara nga pushteti lokal ndaj qytetarëve.*
3. *hartimi i një raport vlerësimi mbi shërbimet publike në Bashkinë Shijak*
4. *takime ndërgjegjësuëse mbi rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen publike dhe nxitjen e llogaridhënies nga ana e struktrave të pushtetit lokal ndaj qytetarëve.*

7. Ambjenti për Qendër Multifunksionale, në Muzeun e Dëshmorëve, për huapërdorje Nr 20804, Dt 13.11.2018. Dhënia për përdorim, pa kundërshtpërblim, shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, të ambientit me sipërfaqe 103 m², pjesë e ndërtesës së Muzeut të Dëshmorëve, që mban Nr. Pasurie 1689, ZK 8512, në inventar të Pallatit të Kulturës “Aleksandër Moisiu”, pronë e Bashkisë, që mban Nr.128 të listës së transferimit, për një afat 5 vjet, për tu përdorur në dobi dhe interes të rinisë.